#kriminalseneisplati
KRIMI NUK PAGUAN

KONFISKIMI I PRODUKTEVE TË KRIMIT NË MAQEDONINË E VERIUT

LIGJI

Konfiskimi i produkteve të krimi

Konfiskimi i produkteve të krimit parashikohet në nenin 97 të Kodit Penal të vitit 2018 (KP).

Askush nuk mund të mbajë produkte të drejtpërdrejta ose të tërthorta nga krimi. Konfiskimi i të produkteve penale sipas kushteve të Kodit Penal urdhërohet me vendim gjykate, i cili e gjen të pandehurin fajtor për krimin.

Gjykata lëshon një vendim konfiskimi sipas procedurës së parashikuar me ligj edhe kur ka pengesa aktuale ose ligjore për të gjykuar autorët e krimit (p.sh. kur ata janë përtej mbulimit nga ligji, në përgjithësi, kanë vdekur ose kur shteti në të cilin ata banojnë e refuzon kërkesën për ekstradim).

Konfiskimi i zgjeruar

Neni 98a i KP-së parashikon konfiskimin e të ardhurave të fituara nga kryerja e krimeve të mëposhtme: (1) organizimi kriminal, për të cilin parashikohen të paktën katër vjet burgim; (2) terrorizmi sipas neneve 313, 394A, 394b, 394C dhe 419 të KP-së, për të cilin parashikohen të paktën pesë vjet burgim; dhe (3) pastrimi i parave, për të cilin parashikohen të paktën katër vjet burgim. Sipas regjimit të zgjeruar të konfiskimit, këto pasuri mund të konfiskohen edhe nga palët e treta, përfitimi i të cilave është siguruar përmes kryerjes së krimeve të listuara, dhe nga anëtarët e familjes së të pandehurit, të të cilët këto pasuri janë transferuar, nëse është e qartë se ato nuk kanë paguar për kompensimin e të pandehurit që korrespondon me vlerën reale të pasurive.

Pasurimi i paligjshëm

Sipas nenit 359a(2) të KP-së, Gjykata urdhëron konfiskimin e pasurive nga kategoritë e specifikuara të zyrtarëve publikë në rast se përcaktohet në një procedurë të përcaktuar me ligj që vlera e tyre i tejkalon ndjeshëm të ardhurat e tyre ligjore.

Paragrafi 5 i këtij neni parashikon konfiskimin e bazuar në vlerën e pasurive të autorit të veprës nëse gjykata konstaton se vlera e pasurive të tij i tejkalon të ardhurat ligjore dhe se ai ka ofruar të dhëna të rreme, jo të plota, ose nuk ka dhënë të dhëna fare, për të vërtetuar origjinën ligjore të pronave të tij dhe se është e pamundur të konfiskohen pasuritë në fjalë.

AGJENCIA

Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara është krijuar në janar të vitit 2009, përmes hyrjes në fuqi të ligjit "Për administrimin e pasurive të konfiskuara, produkteve të krimit dhe instrumenteve të konfiskuara në procedura penale dhe kundravajtje", ("Fletorja Zyrtare e RM-së), nr. 98, datë 04.08.2008.

Funksionet e ADPS-së rregullohen nga ligji "Për administrimin e pasurive të konfiskuara, produkteve të krimit dhe instrumenteve të konfiskuara në procedura penale dhe kundravajtje", ("Fletorja Zyrtare e RM-së), nr. 98, datë 04.08.2008).

Mandati i Agjencisë është:

1. të administrojë pasuritë e konfiskuara, produktet e krimit dhe instrumentalitetet e konfiskuara,
2. me pëlqimin e gjykatës dhe të autoriteteve përgjegjëse, të administrojë përkohësisht pasuritë e ngrira dhe të sekuestruara, produktet e krimit dhe instrumentalitetet e konfiskuara në mënyrë që të ruajë vlerën e pasurisë,
3. të kryejë të gjitha procedurat e përfshira në administrimin e pasurive,
4. të ruajë pasuritë, të kryejë vlerësime të gjendjes dhe vlerës së tyre,
5. të mbajë regjistra të të gjitha pasurive që ka nën administrim dhe të shesë pasuritë,
6. është përgjegjëse për mbajtjen e raporteve statistikore, financiare dhe raporteve të tjera mbi pronat nën administrim,
7. të ofrojë trajnime në lidhje me administrimin e pasurive, si për punonjësit e agjencisë, ashtu edhe për subjekte të tjera të përfshira në procedurat e sekuestrimit dhe konfiskimit,
8. të japë opinione në lidhje me zbatimin e Ligjit "Për Administrimin e pasurive të konfiskuara" dhe të kryejë detyra të tjera, siç përcaktohet me ligj.

KAZUSI "PEPEO"

DËNIMI:	B.S. dhe 32 të tjerë
VENDIMI:	"organizimi kriminal" neni 394(1) i KP-së; "abuzim me detyrën" neni 353(1) i KP-së; "tregti e paligjshme e produkteve të duhanit" neni 60, Ligji "Për akcizën
KOHËZGJATJA E PROCESIT GJYQËSOR:	2009-2011
DËNIMI:	B.S. u dënua me pesë vjet burgim dhe një gjobë prej 25,200 eurosh, ndërsa të pandehurit e tjerë u dënuan me dënime më të buta
PASURITË E KONFISKUARA:	€ 11,750.000 $ 1,050.000

VLERA E PËRGJITHSME E TË ARDHURAVE TË KONFISKUARA:

PERSONA — **6,57 MIL. €**

KOMPANI — **1,05 MIL. $**
5,18 MIL. €

KJO PRONË TANI ZOTËROHET NGA MAQEDONIA E VERIUT

- Konfiskimi i pasurive në këtë çështje është ende në proces (mars 2021)-

2009
DEPOZITIMI I AKTAKUZËS KUNDËR 33 INDIVIDËVE DHE I KËRKESËS PËR KONFISKIMIN E TË ARDHURAVE NGA KRIMI

2010
VENDIM I SHKALLËS SË PARË

2011
DËNIMI PËRFUNDIMTAR NGA GJYKATA E APELIT

2018
HUDOC
European Court of Human Rights

Konfiskimi nuk u trajtua nga vendimi i Gjykatës Evopiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e cila rrëzoi kërkesën për pagim të dëmeve materiale në shumën prej 5,76 milion eurosh, mbi bazën e paaftësisë së B.S-së për të ndërmarrë aktivitetet e nevojshme për funksionimin e duhur të kompanisë TKK, ndërkohë që ai ishte në paraburgim, sepse nuk kishte lidhje shkak-pasojë ndërmjet shkeljes së konstatuar të së drejtës për liri të B.S-së dhe dëmeve materiale të pretenduara.

STANDARDET E PROVËS

Kjo çështje pasqyron qasjen proaktive të Prokurorisë Publike nga fillimi i hetimit deri në momentin kur vendimi i gjykatës u bë vendim i formës së prerë. Prokuoria bashkëpunoi me agjencitë dhe autoritetet shtetërore, duke përfshirë Ministrinë e Brendshme, Administratën e të Ardhurave Publike, Doganat, inspektoratet dhe organet e ngarkuara me parandalimin dhe zbulimin e krimeve sipas ligjit.

Gjatë hetimit u ndërmorën hapat e mëposhtëm: u mblodhën dhe u analizuan të dhënat mbi transaksionet me mjete monetare fizike (cash); u morën masa paraprake hetimi mbi lëvizjen e parave; u morën raporte dhe opinione nga ekspertët e gjykatave; u grumbulluan të dhëna mbi pagesën e detyrimeve financiare dhe grumbullimin e të ardhurave publike nga organet përkatëse. Gjykata realizoi një gjykim të drejtë duke siguruar procedura akuzatore dhe barazinë e armëve dhe mbështeti kërkesën për konfiskim. Akuza e mirëpërgatitur i ndihmoi gjykatat në të gjitha nivelet të mbështesin kërkesat për konfiskim dhe të vendosin në favor të tyre.

ÇFARË DUHET TË PËRMIRËSOHET?

NDRYSHIMET LIGJORE
PARLAMENTI I MAQEDONINË E VERIUT

- Nga ndryshimet ligjore do të përfitonin dispozitat dhe garancitë rreth konfiskimit të palëve të treta dhe mbrojtjes së të drejtave bona-fide të palëve të treta.
- Konfiskimi i zgjeruar i produkteve të krimit, i cili është shumë i gjatë.
- Është e nevojshme të përkufizohet më mirë konfiskimi i zgjeruar, instrumentet, institucionet dhe procedurat që lejojnë kthimin e pasurive.

THE AIRE CENTRE
Advice on Individual Rights in Europe
REGIONAL ANTI-CORRUPTION INITIATIVE
UK Government

Ky material është përgatitur si pjesë e projektit rajonal dy-vjeçar "Forcimi i antikorrupsionit në Evropën Juglindore përmes përmirësimit të masave të kthimit të pasurive". Projekti zbatohet nga Qendra AIRE (Këshillim për të drejtat individuale në Evropë) dhe RAI (Iniciativa Rajonale Antikorrupsion) dhe financohet nga Qeveria Britanike.